



Bashkia Librazhd
Nr. 6026

dt. 16.11.21



Bashkia Prrenjas
Nr. 3112

16.11.2021



Bashkia Peqin
Nr. 1868



Bashkia Elbasan
Nr. 5580/2



Bashkia Gramsh
Nr. 4294 Prod.



Bashkia Cërrik
Nr. 4656/prod

2



Bashkia Belsh
Nr. 3546/2.pnot

AKT THEMELIMI Për krijimin e shoqërisë tregtare “ECO-ELB” sh.a.

Ne ortakët themelues, personat juridikë publikë si më poshtë:

Bashkia ELBASAN, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), me seli në Elbasan, me adresë: **Lagjja “11 Nëntori”, rruga “Qemal Stafa”,** përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Elbasan, **z.Gledian Llatja,**

Bashkia LIBRAZHD, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), me seli në Librazhd, me adresë: **Sheshi “Gjorg Golemi”, Librazhd,** përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Librazhd, **z.Kastriot Gurra,**

Bashkia PRRENJAS, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), me seli në Prrenjas, me adresë: **Rruga “Skënderbeu”, Godina: 15, Prrenjas,** përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Prrenjas, **z.Nuri Belba,**

Bashkia GRAMSH, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), me seli në Gramsh, me adresë: **Sheshi “Kamber Dermushi”, Lagjja “Holta”, Rruga “10 Korriku”, Gramsh,** përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh, **z.Klodian Taçe,**

Bashkia PEQIN, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), me seli në Peqin, me adresë: **Bulevardi “Mustafa Gjinishi”, Peqin,** përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Peqin, **z.Lorenc Tosku,**

Bashkia CËRRIK, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), me seli në Cërrik, me adresë: **Lagjja Nr.2, Rruga “Bulevardi Gjinnazi 1962”, Cërrik,** përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Cërrik, **z.Andis Salla,**

Bashkia BELSH, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), me seli në Belsh, me adresë: **Adresa: Rruga “Hazi Dervishi”, Belsh,** përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Belsh, **z.Arif Tafani,**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr.9723 datë 03.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar,



Vendosim si më poshtë vijon:

NENI 1

Forma juridike

1. Të themelojmë shoqërinë tregtare **"ECO-ELB" sh.a.** në formën e një shoqërie aksionare, me ofertë private.
2. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri **"ECO-ELB" sh.a.**, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të shoqërisë

1. Qëllimi i krijimit të kësaj shoqërie është që nëpërmjet aktivitetit tregtar, sipas objektit të përcaktuar më poshtë, të përmbushë funksionin vendor dhe shërbimin publik për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, si dhe të prodhojë e të shesë energji elektrike që gjenerohet nga procesi i trajtimit të mbetjeve, sikurse parashikohet nga kuadri ligjor e nënligjor në fuqi.
2. Veprimtaria e kësaj shoqërie do të jetë me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3


Emri, logoja dhe vula e shoqërisë

1. Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin **"ECO-ELB" sh.a.** Ajo do të ketë logon dhe vulën e saj.
2. Logoja do të përmbajë fjalë nga emri i shoqërisë.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

1. Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:
 - a) Grumbullimi, rehabilitimi dhe përpunimi i mbetjeve të ndryshme, organike, të ngurta, të gjelbërta, etj., në territorin administrativ të të gjitha bashkive të Qarkut Elbasan;
 - b) Trajtimi i mbetjeve me djegie (incenerator);
 - c) Prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike;
 - d) Aktivitete të tjera në fushën e përpunimit të mbetjeve, që lejon ligji, për interesat e shoqërisë dhe të komunitetit;
2. Shoqëria, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.
3. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj pas marrjes dhe në përputhje me licencat apo lejet përkatëse.



NENI 5

Selia e shoqërisë dhe afati i veprimtarisë

1. Selia e shoqërisë tregtare **"ECO-ELB" sh.a.** do të jetë në Elbasan, me adresë: **"Rruga "11 Nëntori 59, Elbasan"**.
2. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj **për një afat kohor të pacaktuar**, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

Kapitali themeltar


1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 3.500.000 lekë (tre milion e pesëqind mijë) lekë.
2. Ai është i ndarë në 100 aksione të së njëjtës kategori me vlerë nominale prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë, për çdo aksion të shlyer për tërësinë e vlerës nominale të tyre. Aksionet janë të numërtuara nga 1 deri në 100 aksione.
3. Aksionarët themelues të shoqërisë **"ECO-ELB" sh.a.**, zotërojnë në pronësi aksionet si më poshtë:
 - Bashkia Elbasan, zotëron 52% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 52 numër aksionesh, me vlerë 1.820.000 lekë (një milion e tetëqind e njëzetë mijë) lekë.
 - Bashkia Librazhd, zotëron 8% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 8 numër aksionesh, me vlerë 280.000 lekë (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
 - Bashkia Prrerjas, zotëron 8% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 8 numër aksionesh, me vlerë 280.000 lekë (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
 - Bashkia Gramsh, zotëron 8% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 8 numër aksionesh, me vlerë 280.000 lekë (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
 - Bashkia Peqin, zotëron 8% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 8 numër aksionesh, me vlerë 280.000 lekë (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
 - Bashkia Cërrik, zotëron 8% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 8 numër aksionesh, me vlerë 280.000 lekë (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
 - Bashkia Belsh, zotëron 8% të vlerës së aksioneve, në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, të barabartë me 8 numër aksionesh, me vlerë 280.000 lekë (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

NENI 7

Përbërja e kapitalit të shoqërisë

1. Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para dhe/ose në natyrë i aksionarit themelues të kësaj shoqërie.
2. Kontributi në para do të jetë i përbërë nga shuma prej 3.500.000 lekë (tre milion e pesëqind mijë) lekë, që është edhe vlera minimale e kapitalit themeltar për shoqërinë, me ofertë

Një e katërta e vlerës nominale të aksioneve (kapitalit të shoqërisë), në shumën 875.000 (tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë është depozituar në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT), dega Elbasan, në llogarinë "Shoqëri në Formim e Sipër", në datën e nënshkrimit të këtij akti themelimi, nga Bashkia Elbasan. Pas regjistrimit, kjo shumë do të kalojë në



llogarinë e kësaj shoqërie, që do të çelet pranë BKT. Në llogarinë e shoqërisë çelet llogaria “Fondi themeltar i aksionarit”, ku regjistrohet vlera e kapitalit të tij.

NENI 8

Organet drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve - organi më i lartë vendimarrës;
- Këshilli Mbikqyrës - organ i mbikqyrjes;
- Administratori - organ ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9

Këshilli Mbikqyrës

1. Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 deri në 21 anëtarë, të cilët nuk mund të jenë njëkohësisht dhe administratorë të shoqërisë. Ata zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e votave të aksionarëve që marrin pjesë.
2. Aksionarët e shoqërisë kanë të drejtë të për zgjedhin secili nga 1 (një) anëtar në përbërjen e Këshillit Mbikqyrës.
3. Këshilli Mbikqyrës i parë i shoqërisë përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të cilët janë caktuar si më poshtë:

- Z. Klejdi Muci datëlindjes 7.3.1984 lindur e banues në Elbasan, identifikuar me ID nr. I40307144H;
- Z. Afrim Shkilla datëlindjes 6.10.1984 lindur e banues në Elbasan, identifikuar me ID nr. I41006127D;
- Z. Maraglen Bali i datëlindjes 17.03.1988 lindur e banues në Belsh, identifikuar me ID nr. I80317012S;
- Z. Andri Çetai datëlindjes 8.7.1986 lindur e banues në Elbasan, identifikuar me ID nr. I60708016P;
- Z. Hoxhi S. Çollaku datëlindjes 15.12.1976 lindur e banues në Elbasan, identifikuar me ID nr. H61215156F;
- Z. Jrlend Sina i datëlindjes 14.12.1968 lindur e banues në Elbasan, identifikuar me ID nr. G91214040G;
- Z. Tomorr Zaimaj datëlindjes 22.02.1958 lindur e banues në Cërrik, identifikuar me ID nr. F80222007B;

4. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës do të jetë 3 (tre) vjet. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen.

NENI 10

Administratori

1. Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat 3 (tre) vjeçar.
2. Administratori i parë i shoqërisë tregtare “ECO-ELB” sh.a. është z/nj. Arjola Hemetaj i datëlindjes, me ID: 185923080R



3. Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i saj, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 11

Eksperti kontabël

1. Shoqëria tregtare **"ECO-ELB" sh.a.** do të ketë 1(një) ekspert kontabël të autorizuar.
2. Eksperti kontabël i autorizuar i shoqërisë është z. Armond Avdoli datëlindjes 18.07.1977 identifikuar me ID nr. H7071800 pajisur me licensë nr. 298.

NENI 12

Autorizimi për procedurat e themelimit

Ortakët themelues autorizojnë Kryetarin e Bashkisë Elbasan për të aplikuar për regjistrimin fillestar të shoqërisë aksionare **"ECO-ELB" sh.a.** sipas kërkesave të Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

NENI 13

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 14

Aksionarët themelues mund të vendosin, me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në shoqëri të tjera dhe mund të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, përveçse atij që mund të jetë konkures me atë të shoqërisë tregtare **"ECO-ELB" sh.a.**

NENI 15

Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen me mirëkuptim nga aksionarët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga gjykata kompetente sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Aksionarët e shoqërisë:

BASHKIA ELBASAN

Përfaqësuar nga
KRYETARI
Gledian Llaça

BASHKIA LIBRAZID

Përfaqësuar nga
KRYETARI
Kastriot Gurra

BASHKIA PRRENJAS

Përfaqësuar nga
KRYETARI
Nuri Belba

BASHKIA GRAMSH

Përfaqësuar nga
KRYETARI
Klodian Tace

BASHKIA PEQIN

Përfaqësuar nga
KRYETARI
Lorenç Tosku

BASHKIA CËRRIK

Përfaqësuar nga
KRYETARI
Andis Salla

BASHKIA BELSH

Përfaqësuar nga
KRYETARI
Arif Tafani

18.11.2021